



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A
DREJTORIA JURIDIKE

Tiranë, më 15.12.2022

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbimi i marrjes në rrugë valore të sinjaleve të alarmit, verifikimit dhe reagimit me grup të gatshëm në të gjitha filialet e degët e Postës Shqiptare”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): (Shërbime roje/shërbime me roje)

VLERA E FONDIT LIMIT: 19,935,720 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e trdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëzet) Lekë, pa TVSH

AFATI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT: do të jetë për 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarik.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në vlerën 398,714,40 (treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e katërbëdhjetë presje dyzetë) Lekë.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve të fundit 2019, 2020 dhe 2021, **ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 95% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që ka realizuar Shërbime të ngjashme, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori Ekonomik fitues duhet të jetë pajisur me License të ushtrimit të aktivitetit të kategorisë 1.3.A për çdo qark “Për ruajtjen e sigurimin e objekteve dhe pronave” në përmbushje të plotë të detyrimeve që përcakton Ligji Nr.75/2014 “Për Shërbimin privat të Sigurisë Fizike”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 14/1 të Ligjit nr. 75

/2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike dhe në Kreun I, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatë të Titullarit dhe Drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 14/b/c të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike dhe në Kreun I, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi të 12 (dymbëdhjetë) qarqet e Shqiperise.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 14/c të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në pikën D. Qendra e Kontrollit, të Kreut VII, Uniformat, mjetet, pajisjet e shërbimit, dokumenti I identifikimit të punonjësve të SHPSF-SË, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm dhe në pikën 1, të Neni 65 Përdorimi i frekuencave, të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se: Personat fizikë apo juridikë mund të përdorin frekuencë vetëm pasi të jenë pajisur, paraprakisht, me autorizim nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike (pajisjet e shërbimit) për të zbatuar kontratën.

2.3.5 Operatori ofertues duhet të paraqesë Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit për të 12 Qarqet e Shqipërisë sipas **Udhëzimit Nr.130 dt. 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm “Per Funkcionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” ku ushtron aktivitetin SHPSF.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Kreu VII, Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të Shpsf-së, pika B. Mjetet dhe pajisjet e shërbimit, pika 1/b, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të disponojë në stafin e tij minimalisht 10 (dhjetë) punonjës shërbimi për çdo qark. Për kete operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim performace nga Drejtorite e Policise se Qarkut konform ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) të ndryshuar si dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij. Ky vërtetim duhet të përmbajë informacionin dhe opinionin që disponojnë Drejtorite e Policisë së Qarkut sa më poshtë për:

a) Qendra e kontrollit të shërbimit.

b) Të ketë punonjës të licencuar nga DPQ-të përkatëse për kategorinë 1.3.A, jo më pak se 10 punonjës për çdo Qark

c) Vërtetimet e performances nga DPQ-të duhet të jenë lëshuar mbas muajit qershor të vitit 2022.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: **Referuar specifikimeve teknike ku kërkohet Shërbimi i marrjes në rrugë valore të sinjaleve të alarmit, verifikimit dhe reagimit me grup të gatshëm në Filialet, Degët dhe Zyrat Postare, referuar në KREU KREU VII, Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të Shpsf-së, Germa E. Organizimi i shërbimit në Qendrën e Kontrollit, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm, duhen minimumi 10 (dhjetë) punonjës shërbimi për çdo qark duke u nisur nga fakti se zyrat postare kanë shtrirje jo vetëm në qendra qarqesh por në të gjitha qytetet dhe fashatrat kryesore referuar në KREU V, MENAXHIMI I SHËRBIMEVE TË SHPSF-SË, Germa A. Organizimi dhe drejtimi i SHPSF-së, Pika 2/c/ ku parashikohet që koeficienti 1.66 për një punonjës shërbimi, si dhe pika 13. Për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë lidhur me këto sisteme, SHPSF-ja detyrohet të mbajë të gatshëm një grup punonjësish me përbërje jo më pak se 2 (dy) punonjës për çdo turn, **numri i kërkuar është numri minimal i nevojshëm për realizimin e këtij shërbimi, kërkesë kjo për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.****

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të disponojë jo me pak se 1 (një) automjet për çdo qark për verifikimin me grupe të gatshme dhe 3 (tre) automjete të tjera për mirëmbajtjen e sistemeve të sigurisë, shoqëruar me kontratë shitblerje ose certifikatë pronësie ose kontratë qiraje të noterizuar si dhe për të gjitha mjetet të paraqitet certifikata e pronësisë, leje qarkullimi, vërtetim për taksat e paguara dhe siguracion i vlefshëm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Kreu VII, Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të Shpsf-së, pika B. Mjetet dhe pajisjet e shërbimit, pika 1/b, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

Sqarim! Të gjitha kriteret e sipërcituara në **Shtojca 8, të DST-së**, të cilat përfshihen në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojca 9, të DST-së, **do të vlerësohen të përmbushura në fazën e vlerësimit të ofertave të ofertuara në SPE.***”

*Referuar përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, **Ofertuesi fitues, përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.***

NJËSIA E PROKURIMIT